



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 385/2014

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Nehat Idrizi, dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Prishtinë, paraqitur kundër Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve (QNR)-Prishtinë, për shkak të shpalljes të pavlefshme të fletëvotimeve, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare të datës 08.06.2014, në seancën e panelit të mbajtur me 24.06.2014, mori këtë:

#### VENDIM

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Prishtinë.

#### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 23.06.2014, nga subjekti politik AKR dega në Prishtinë, me të cilën pretendohet se gjatë rinumërimit të votave në kuti, në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), në vendvotimin me nr. 1801x/03R i komunës së Podujevës, kanë gjetur 32 fletëvotime të pavlefshme të cilat janë të dëmtuara me qëllim nga komisionarët në vendvotim dhe siç thekson ankuesi se ato vota janë të subjektit politik AKR dhe Lëvizjes Vetëvendosje.

Parashtruesi i ankesës në cilësinë e dëshmitarit ka propozuar Ismet Mulaj.

Bazuar në nenin 117. 2 të LZP-së PZAP-i *“Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme “*

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën dhe bëri hetimin e fletëvotimeve të kontestuara gjeti se:

#### **ankesa është e pabazuar**

PZAP-i ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore të parashtruara nga subjekti politik AKR në kuptim të nenit 12.1 të Rregullave dhe Procedurave të tij ka caktuar një hetues kryesor dhe një zyrtar të lartë ligjor nga sekretariati për ta bërë administrimin e hetimeve të 32 fletëvotimeve për të cilat subjekti në fjalë pretendon në ankesën e tij se është dëmtuar me këto fletëvotime në momentin e shpalljes si të pavlefshme nga komisionarët në vendvotimin 1803x/03R.

Nga ekipi hetues i PZAP-it është hapur kutia e votimit me numër 1801x/03R për komunën e Podujevës e cila kuti ka qenë e mbyllur me 4 shirita anësor të sigurisë me ngjyrë të gjelbërt të cilët shirita kanë mbajtur këta numra: 0035840, 0037827, 0037713 dhe 0037828 poashtu ka qenë e mbyllur kjo kuti e votimit edhe me shiritin e sigurisë me ngjyrë të kaltër i cili mbanë numrin 0037828. Po ashtu e njëjta kuti e votimit është mbyllur më katër shirita të sigurisë më ngjyrë të gjelbërt më nr: 0036107, 00366108, 0036109 dhe 0036110, ndërsa shiriti i sigurisë me ngjyrë të kaltër i cili mbanë numrin 0037828 (i cili gjendet në mes të kutisë së votimit), nuk prekur fare prandaj edhe ka mbetur i njëjti.

Pas hapjes së kësaj kutie në brendi të saj kanë rezultuar 32 (tridhjetë e dy) fletëvotime të pavlefshme siç edhe është pretenduar në ankesë nga pala ankuese.

Pas hetimit të fletëvotimeve të dyshimta PZAP-i ka konstatuar se 26 (njëzet e gjashtë), fletëvotime janë të dëmtuara (të shkarravitura me laps kimik), që e bënë të paqartë qëllimin e votuesit se për cilin subjekt politik ka dëshiruar të votojë.

Për 5 (pesë), fletëvotime të dyshimta PZAP-i ka konstatuar se në të gjitha këto fletëvotime është shënuar në fletëvotim më shumë se një subjekt politik prandaj edhe është i paqartë qëllimi i votuesit se për cilin subjekt politik ka dëshiruar të votojë.

Për 1 (një), fletëvotim të dyshimtë PZAP-i ka konstatuar se nuk është i vulosur me vulën zyrtare të fletëvotimeve.

Për më tepër lidhur me pretendimin ankimor se me rastin e shpalljes së këtyre fletëvotimeve të pavlefshme është dëmtuar subjekti politik AKR dhe subjekti Vetëvendosje (VV), nuk qëndrojnë sepse nga 32 fletëvotimet të përmendura më lartë, vetëm në 1 (një) fletëvotim është shënuar nga votuesi te numri 40 i subjektit politik AKR dhe numri 35 i subjektit VV, që nënkupton se në këtë fletëvotim votuesi i ka shënuar dy subjekte politike dhe ka shkarravitur mbi fletëvotim me laps kimik.

Poashtu në një fletëvotim tjetër nga votuesit janë shënuar subjektet politike: me numër 36 VAKAT, 39 Pokret Za Demokratski Prosperitet (PDP), 40 AKR, 43 Boshnjačka Jedinstvena Lista dhe 47 Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), që nënkupton se në këtë fletëvotim votuesi i ka shënuar pesë subjekte politike.

Lidhur me pretendimet ankimore se fletëvotimet në fjalë janë shpallur si të pavlefshme dhe është dëmtuar subjekti politik AKR nuk qëndrojnë ngase të gjitha fletëvotimet e lartpërmendura nuk i plotësojnë kriteret si fletëvotime të vlefshme në kuptim të nenit 7 par.2 pikat (a) (b) dhe (c) të Rregullës Zgjedhore nr.06/2013.

*Në pikën (a) të dispozitës të lartpërmendur përcaktohet se :*

- (a) në fletëvotim është shënuar më shumë se një subjekt politik ose*
- (b) mënyra se si është shënuar fletëvotimi e bënë qëllimin e votuesit të paqartë ose*
- (c) nuk është vulosur me vulën zyrtare të fletëvotimeve.*

Nga kjo dispozitë ligjore dhe nga arsyet e cekura më lartë del se asnjë nga 32 fletëvotimet për të cilat pretendohet në ankesë se janë shpallur të pavlefshme dhe se janë dëmtuar me qëllim nuk qëndrojnë ngase asnjëra prej tyre nuk i plotëson kushtet të shpallen si fletëvotime të vlefshme.

Andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së lidhur me ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë**

Anr. 385/2014 më datën 24.06.2014



***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*